



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

---

**K.Dh.SHK.II.nr.1656/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.U “Hidroregjioni Jugor” sh.a, Njësia në Prizren, me nr. të biznesit 70433702, me seli në Prizren, rr. “Wesley Clark” p.n, kundër debitorit Selia e Partisë AKR, me adresë në Malishevë, rr. “Adem Jashari” ML02, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.305/22 i datës 26.09.2023, me datë 07.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e kreditorit K.R.U “Hidroregjioni Jugor” sh.a, Njësia në Prizren, me nr. të biznesit 70433702, me seli në Prizren, rr. “Wesley Clark” p.n, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.305/22 i datës 26.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.305/22 i datës 26.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit Selia e Partisë AKR, me adresë në Malishevë, ashtu që **ANULOHET** Urdhri Përmbarimor P.nr. 147/2019 i datës 26.12.2019, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Ymer Kastrati.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të drejte të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar apo lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ankesa e të autorizuarës së kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit .R.U “Hidroregjioni Jugor” sh.a, Njësia në Prizren, me datë 26.12.2019 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 147/2019, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit: Kartela e klientit me shifër KONS – 0034280 dhe faturës për muajin nëntor 2019, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga ekstrakti i lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 560.63 EUR, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se ka skaduar afati kohor brenda të cilit debitori ka mundur ta kërkoj përbarimin. Tutje ka shtuar se kreditori nuk ka paraqitur asnjë kontratë përmes të cilës vërtetohet se cili ka qenë borxhi paraprak, ndërsa borxhi i kërkuar nuk dihet se për cilën periudhë kohore është akumuluar. I ka propozuar gjykatës që aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar si dhe të shfuqizohet urdhri për përbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka theksuar se në rastin konkret procedura përbarimore është bazuar në faturat apo ekstraktet e paraqitura sipas nenit 21, lidhur me nenin 40 të LPPsë, nga të cilat konstatohet borxhi që debitori ka për kreditorin, ndërsa pretendimet e debitorit nuk janë të mbështetura me asnjë provë të vetme. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.305/22 i datës 26.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit Selia e Partisë AKR, me adresë në Malishevë, ashtu që e ka anuluar Urdhri Përbarimor P.nr. 147/2019 i datës 26.12.2019, i lëshuar nga Përbaruesi Privat Ymer Kastrati, duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pasi analizoj prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të gjeti se i njëjti është i bazë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht neni 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*. Prandaj , Kjo gjykate vlerëson se dokumenti - Kartelë e klientit me shifër të konsumatorit nr. 0034280 në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës dhe nuk është përfshirë periudha kohore për të cilën kërkohet përmbartja e detyrimit. Po ashtu, Kjo Gjykate vlerëson se kartela e klientit nr. 0034280 përfshin periudhën kohore nga 01.01.2018 e deri më 17.12.2019 në shumë prej 49,68 EUR, ndërsa si saldo në këtë ekstrakt figuron shuma prej 513.11 EUR, por nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë. Andaj Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor në rastin konkret, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbartimit.

Po ashtu, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë , vlerësoj edhe dokumentin faturë për muajin nëntor 2019, nuk është i përshtatshëm për përmbartim dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbartimit pasi që i njëjti nuk është pranuar nga debitori, pasi që nuk përmban nënshkrimin e debitorit si në faturë, ndërsa kreditori nuk ka ofruar prova se faturën e lartcekur i ka dorëzuar debitorit ashtu që i njëjti është njoftuar me detyrimin që rrjedh nga ajo.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori ka ofruar provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit lidhur me propozimin për përmbartim të lëshuar nga përmbartuesi privat.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka

aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe kur e ka anuluar urdhrin përmbaremore P.nr. 147/2019 të datës 26.12.2019.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SHK.II.nr.1656/23 dt. 07.02.2024

**Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi**